




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASENIT UJOR SHKUMBIN

VENDIM
Nr.25, datë 19.12.2024



PËR
**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR TRANSFERIM TË LEJES, NGA
SUBJEKTI “SH.A UJËSJELLËS KANALIZIME PEQIN” TEK
“SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME ELBASAN”.**

Në mbështetje të shkronjës “b” të pikës 2, të nenit 41, të ligjit nr.111/2012, “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, i ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim për dhënien me koncension të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujrave të pëdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimarrjes, të formateve të lejes, të autorizimit, të kushteve të posaçme dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Shkumbin,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për transferimin e lejes Nr.A 2, datë 5.5.2009 “Leje për përdorim të rezervës ujore e lidhje kontrate, për furnizim të popullatës me ujë të pijshëm, nga Sh.A.Ujesjelles Peqin,

Nga subjekti “SH.A Ujësjiellës Kanalizime Peqin” me Nipt K78723108J tek subjekti “Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Elbasan” sh.p.k me Nipt M23322201V.

2. Treguesit paraprakë janë si më poshtë

PEmërtimi i burimit	KOORDINATAT KRGJSH		Q
	X	Y	l/s
Pus shpimet në zonën e Pishave	478719.6	4544750.2	50
Pus shpimi në zonën e Karinës	475007.9	4546866.2	6
Pus shpimi në Fatish	481095.2	4544822.4	6
Pus shpimi në Rodaj	482747.4	4544502.3	6
Pus shpimi në Lolaj	483908.7	4546007.1	3
Pus shpimi në Lazarej	485840.5	4545611.5	12



Pus shpimi në Bishqem Kodër	488640.6	4547296.4	4
Pus shpimi në Paulesh	491290.3	4548345.3	4
Pus shpimi në Gryksh	488310.2	4547018.3	9
Pus shpimi në Trash	485230	4543797.4	6
Pus shpimi në Shezë	484115.7	4544445.8	5
Pus shpimi në Vashaj	480657.2	4543908.4	8
Pus shpimi në Rrumbullak	479087.1	4543326.1	6
Pus shpimi në Bardhas	477639.4	4545606.6	4
Ujëmbledhësi në Garunjë	489650.2	4554148.3	5
Ujëmbledhësi në Cacabezë	488556.3	455260.1	5

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

KRYETARI I KBU SHKUMBIN

ALI MYSLIU

